



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1597/2 prot.,

Datë 19.06.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM  
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR  
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALMedical” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur e Thjeshtuar*”, me REF-03081-04-30-2024 me objekt “*Blerje Qelqurina*”, me fond limit 4,028,936 (*katër milion e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë*) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 07.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “ALMedical” SHPK me NIPT K21511002I, me adresa: Rruga “Shefqet Musaraj”, Banesa nr. 17, Tiranë.

**Subjekt i Interesuar:** Operatori ekonomik “Lab Chem Distribution” SHPK me NIPT M12429007A, me adresa: Rruga e Teleferikut, Zona Kadastrale Nr. 2460, Numer pasurie 192/41-118, Linzë, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.  
Adresa: Rruga “Qamil Guranjaku”, Tiranë.

Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2024/4222, datë 14.06.2024 dhe me Nr. 1597/2024 Prot., date 18.06.2024 e operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur e Thjeshtuar*”, me REF-03081-04-30-2024 me objekt “*Blerje Qelqurina*”, me fond limit 4,028,936 (*katër milion e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë*) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 07.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose

enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit si më poshtë vijon:

### **Arsyet e skualifikimit:**

*Referuar Dokumentave Standarte të Tenderit: Seksioni 2; Kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.3: Kapaciteti teknik, pika e, nga ofertuesit e mundshëm kërkohet 2.3 d) Për artikujt e shënuar me Asterisko (\*), duhet të paraqiten mostra ditën e hapjes se ofertave, me date 29.05.2024 ne oren 10:00. Dorëzimi i kampioneve/ mostrave, të bëhet prane Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse pranë NJVKSH Tiranë, te mbyllura ne nje zarf /kuti jo transparente te vulosur mbi te cilin te shenohet:*

– “Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave te procedurës se prokurimit « ..... » dhe jo para dates 29.05.2024, ora 10:00.

– Se bashku me mostrat ofertuesi duhet te japë edhe një shkrese te vulosur dhe firmosur ku te listohen mostrat qe ndodhen ne zarf/kuti.

– Mbi çdo mostër te dorëzuar, ofertuesi duhet te shënoje Nr.Rendor te Artikullit qe përfaqëson.

*Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë te shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj te veçantë, atëherë oferta do te quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do te s’kualifikohet.*

*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pas marrjes në dorëzim të mostrave procedoi duke mbajtur një proces verbal për numërtimin e mostrave për testim dhe i dërgoi me shkrese shefit të Sektorit të Shërbimit të Epidemiologjisë dhe Shëndetit Mjedisor (këtu e më poshtë SESHM) me nr.1386 prot, datë 31.05.2024 për verifikim profesional ose testim sipas rastiit të mostrave. Në bazë të kthimit të përgjigjes nga shefi i SESHM me nr.1386/1 prot, datë 06.06.2024 rezulton se pas gjykimit për verifikim profesional ose testim sipas rastiit të mostrave nga përdoruesit direkt të tyre, Artikulli me nr 14, maja pipete, Maja per mikropipete Ependorf,ose ekuivalent, 10-100 µl , e operatorit ekonomik Almedical, nuk janë të përshtatshme për mikropipetën (10-100 µl) që procedojmë. Maja nuk qëndron e fiksuar dhe bie, gjë që bën të pamundur procedimin me të. Në katalogun e dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike nga operatorit ekonomik Almedical, Artikulli me nr 14 është markuar për 5-100 µl.*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 19.06.2024

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**